



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9 Maj 2023

Nr: 469

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 174 ID, 175 ID, 213 ID, 214 ID, 215 ID, 218 ID, 233 ID TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 9 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Florenc Doka person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik;
Z. Florenc Cerhozi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Krujë;
Z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll;
Z. Artur Kala, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Agjencinë Kombëtare e Pyjeve.
Z. Martin Dodi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Fier;
Z. Reinis Çela person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së

Data: 9 Maj 2023

Nr: 469
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ka depozituar denoncimet regjistruar me numër 174 ID, 175 ID, 213 ID, 214 ID, 215 ID, 218 ID, 233 ID.

Janë administruar indicie për organizimin e 7 (shtatë) veprimtarive publike, nga 6 (gjashtë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për Kundravajtjet Administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të raportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljevetë pretenduara.

Institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

1- Denoncimet e regjistruara me nr. 174 dhe 175 ID ndaj Bashkisë Cërrik, për 2 (dy) veprimtari publike, për të cilat pretendohet si vijon:

- **Denoncim nr. 174 ID,** *“Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 4 Mars 2023, zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Dasar”, të planifikuar për t’u zhvilluar në datën 10 Mars 2023. Drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, z. Damian Gjikhuri në datën 6 Mars 2023, ka postuar në faqen e tij në Facebook foto dhe video të zhvillimit të aktivitetit me tekstin: “Banorët e fshatit Dasar në Njësinë Administrative Mollas së shpejti do kenë gati rrugën e re me të gjitha standardet. Ky investim, një kërkesë e kahershme e komunitetit, ishte tepër i domosdoshëm edhe për fermerët të cilëve u krijohet mjaft lehtësi për transportin e prodhimeve të tyre. Realizimi i projektit që përfshin ndërtimin e mureve mbajtës dhe asfaltimin e rrugës vjen edhe falë mirëmenaxhimit të fondeve nga bashkia Cërrik dhe kryetari z. Andis Salla i cili taksat e qytetarëve i përkthen në investime për ta. Në Njësinë Administrative Mollas para pak kohësh ka përfunduar edhe rrjeti ujësjellës që furnizon me ujë 24 orë në ditë të gjithë zonën. #TëBashkuarJoTëNdarë#ShqipëriaeArdhmjaJonë#SkaKohëPërPushim*

Zhvillimi i aktivitetit është postuar në datën 10 Mars 2023 në faqen Facebook të Bashkisë Cërrik dhe në faqen Facebook të kryetarit të Bashkisë Cërrik z. Andis Salla. Postimi ka përmbajtjen e mëposhtme: “DASAR Ku bashkë me Damianin inspektuam punimet që kanë nisur për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës së këtij fshati. Ky investim vjen si zgjidhje e një kërkesë të kahershme të banorëve të këtij fshati, të cilën sot ne e realizojmë me fonde totalisht të Bashkisë Cërrik. #BashkiaCërrik#SkaKohëPërPushim#ShqipëriaeArdhmjaJonë”.

- **Denoncim nr. 175 ID,** *“Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 25 Shkurt 2023, zhvillimin e aktivitetit me temë “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, të planifikuar për t’u zhvilluar në datën 6 Mars 2023. Drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, z. Damian Gjikhuri në datën 4 Mars 2023 ka postuar në faqen e tij në Facebook foto dhe video të zhvillimit të aktivitetit me tekstin: “Banorët e fshatit Selvias në Njësinë Administrative Klos brenda muajit do kenë gati rrugën e re, një ndihmë e jashtëzakonshme për ta sepse përveçse shkurton distancën me qytetin, sjell edhe lehtësi në qarkullimin e automjeteve dhe transportin e prodhimeve. (...)”.*

Zhvillimi i aktivitetit është postuar në datën 7 Mars 2023, në faqen Facebook të Bashkisë Cërrik dhe në faqen Facebook të kryetarit të Bashkisë Cërrik z. Andis Salla. Nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit dhe institucionit përkatës, nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra, rezulton se aktiviteti është kryer dhe data e deklaruar për zhvillimin e tij, në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së, ka qenë e plotësuar gabim."

Më datë 13.3.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Cërrik, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk është administruar asnjë përgjigje nga ky Institucion, në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Cërrik.

Në përfundim të hetimit administrativ **për denoncimet e regjistruara me nr. 174 ID dhe nr. 175 ID**, për bashkinë Cërrik vlerësoj se:

Referuar nenit 4, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator *"Struktura përkatëse e teknologjisë së informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mundëson akses të personalizuar në këtë ndërfaqe për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, me qëllim që të hedhin të dhënat për **institucionin që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë**", institucioni organizator ka detyrimin që të raportojë në **ndërfaqe, 5 (pesë) ditë** para të gjitha aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut, duke plotësuar çdo rubrikë që përcaktohet në këtë nen.*

Të dhënat e marra nga ky nen, ndihmojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në vlerësimin e një veprimtarie si "të lejuar" apo "të ndaluar" për t'u zhvilluar, si dhe monitorimin e saj, në rastet kur e konsideron të arsyeshme. Mosplotësimi i këtyre të dhënave, në formën e kërkuar nga vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, do të çonte në një vlerësim jo të drejtë si dhe në pamundësinë për të monitoruar këtë aktivitet.

Institucionet, të cilat vërejnë se kanë bërë gabime materiale në raportimin e aktivitetit apo kanë ndryshim agjende dhe nuk mund ta kryejnë aktivitetin, sipas të dhënave të raportuara,

në çdo kohë duhet të venë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili vlerëson nëse aktiviteti i raportuar mund të zhvillohet apo jo.

Veprimtaritë publike objekt i denoncimeve të regjistruara me nr. 174 ID dhe 175 ID, janë raportuar për t'u kryer në data të ndryshme, nga ato që faktikisht janë kryer. Nëse gabimet e kryera nga ana e personit përgjegjës për raportim do të ishin gabime materiale, raportimi do të ishte në shkelje të afatit 5 (pesë) ditor, të përcaktuar nga neni 92, të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Cërrik përbën shkelje të nenit 92, pika 3, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 4, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Referuar pikës 1, të nenit 10, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, **raportojnë pjesërisht** ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisionieri Shtetëtor i Zgjedhjeve me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, personi përgjegjës për bashkinë Cërrik z. Florenc Doka, sanksionohet në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë.

2- Denoncimi regjistruar me nr. 215 ID ndaj Bashkisë Krujë, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 215 ID, "Sot, më 22 Mars, Ramiz Kovaçi do festonte ditëlindjen e 94-rt, e cila u kujtua përmes përjetësimit të tij në qytetin ku lindi, pranë lagjjes që hodhi hapat e parë të jetës! Shumë krenar që në këtë ditë të shenjtë, qytetit i shtohet busti i një artisti që ka lënë shenjë në artin shqiptar...!"**

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=755202799305854&set=pcb.755204895972311>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 28.3.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Krujë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Krujë, nuk i është përgjigjur kërkesës tonë

Data: 9 Maj 2023 Nr: 469
Ora: 12:00



për

informacion, në këto kushte, është

"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike"

vijuar me gjykimin e rastit në bazë të provave të administruara nëpërmjet rrjetit social "Facebook", postuar në faqen e kryetarit të Bashkisë Krujë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancën dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i bashkisë Krujë, i cili lidhur me aktivitetin objekt denoncimi bëri me dije se: *Bashkia Krujë më datë 22 Mars nuk ka organizuar asnjë aktivitet publik, por ka marrë pjesë në një aktivitet publik ku është ftuar nga familja e zotit z. Kovaçi dhe ne ceremoninë e inagurimit ishin prezent familjarë të familjes, institucioni i bashkisë Krujë, ambasadori i Republikës së Bullgarisë në Shqipëri, si dhe nënkryetari i bashkisë Krujë. Si provë materiale nga KRIIK është marrë nga media sociale e kryetarit të bashkisë. Për sa i përket mediatizimit bashkia nuk ka lançuar asnjë ftesë për mediat lokale. Një korrespondent lokal i ABC News i cili është ftuar nga ana e familjes dhe jo nga bashkia Krujë pasi nuk ka qenë një aktivitet i zhvilluar nga bashkia Krujë, por si pjesë e komunitetit bashkia është ftuar të marr pjesë."*

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, provohet se veprimtaria publike rast hetimi është zhvilluar në ambientet e jashtme publike të bashkisë Krujë.

U provua se kjo veprimtaria publike, nuk është postuar në faqen zyrtare të rrjetit social "Facebook", të Bashkisë Krujë.

Duke qënë se provat e administruara janë vetëm foto, nuk provohet nëse ka thirrje elektorale gjatë këtij takimi, por provohet se kryetari i bashkisë Krujë z. Artur Bushi, ka qenë i pranishëm në këtë takim.

Nuk u arrit të provohet që në këtë takim ka pasur të pranishëm punonjës të bashkisë.

Në përfundim të hetimit adiministrativ, pasi u shqyrtuan pamjet filmike, provat dhe faktet, vlerësoj se veprimtaritë e kryera nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Vlerësoj se

3- Denoncimi regjistruar me nr. 213 ID ndaj Bashkisë Devoll, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 213 ID, "Bashkia Devoll, në bashkëpunim me gjimnazin "Fuat Babani" Bilisht, zhvilluan sot një aktivitet me rastin e ditës ndërkombëtare të poezisë".**

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=584770807014071&set=pcb.584770953680723>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 28.3.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Devoll, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Devoll, nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion, në këto kushte, është vijuar me gjykimin e rastit në bazë të provave të administruara nëpërmjet rrjetit social “Facebook”, postuar në faqen e bashkisë Devoll.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Devoll.

U provua se kjo veprimtari publike, është postuar në faqen zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të Bashkisë Devoll, në ambientet e Brendshme të një institucioni public sikurse është dhe gjimnazi “Fuat Babani”. Nga verifikimi dhe administrimi i provave rezulton që ky takim është zhvilluar në prani të mësuesve dhe nxënësve të këtij gjimnazi.

Duke qënë se provat e administruara janë vetëm foto, nuk provohet nëse ka thirrje elektorale gjatë këtij takimi, por provohet se kryetari i bashkisë Devoll z. Eduart Duro, ka qënë i pranishëm në këtë takim.

Konstatohet që takimi nuk ka qënë rastësor por i organizuar dhe i planifikuar për tu zhvilluar.

Nuk u arrit të provohet që në këtë takim ka pasur të pranishëm punonjës të bashkisë.

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktiviteti i mësipërm, përbën veprimtari publike, dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të hetimit administrativ vlerësoj se:

Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruar me **nr. 213**

ID, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “*Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve*”, bashkia Devoll ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “*raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)*”.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se “*shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor...nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë*”, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll, ka shkelur pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

4- Denoncimi regjistruar me nr. 233 ID ndaj Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 233 ID, "Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, z. Artur Kala bashkë me kryetarin e bashkisë Devoll, Z. Eduard Duro morën pjesë në përfundimin e punimeve të pyllëzimeve në Ekonominë Pyjore "Përparimaj-Dardhe", në vendin e quajtur Dëmbrevë. Projekti i pyllëzimeve i hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit, Devoll u zbatua gjatë viteve 2022 -2023. Gjithsej janë mbjellë 5500 fidana pyjor, të llojit pishë e zezë (Pinus nigra). Për mbjelljen e tyre kontribuan specialistët e Drejtorisë të Pyjeve dhe Mjedisit, punonjësit e sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, punëtorët e Drejtorisë të Shërbimeve të bashkisë Devoll gjithashtu kontribuan specialist me eksperiencë të gjatë në sektorin e pyjeve dhe nxënësit e Gjimnazit "Fuat Babani", Bilisht."**

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=259389486416365&set=pcb.259390123082968>

Gjithashtu theksohet se aktiviteti publik është transmetuar në një media.

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

Më datë 3.4.2023, **Agjencisë Kombëtare të Pyjeve** i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe jemi informuar se:

- *“Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, shfrytëzimin e qëndrueshëm e shumëfunksional të burimeve pyjore, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare. Përgjegjësitë e saj përcaktohen në pikën 2, të nenit 15, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet” dhe VKM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i ndryshuar.*
- *Në përmbushje të misionit të saj Agjencia Kombëtare e Pyjeve, “harton, zbaton dhe monitoron plane, programe e projekte që synojnë miradministrimin, ruajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor, në bashkëpunim dhe koordinim me institucione në nivel qendror e vendor, me donatorë/partnerë zhvillimorë, me organizma të shoqërisë civile dhe biznesit”. Bashkëpunimi me Njësinë e Vetëqerisjes Vendore është një nga prioritetet e punës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për përmbushjen e misionit të saj, në lidhje me zhvillimin e fondit pyjor, ku bëjnë pjesë edhe projektet e pyllëzimeve.*
- *Projekti i pyllëzimeve është hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit të Bashkisë Devoll. Ky projekt ka nisur të zbatohet që prej vitit 2022 dhe është parashikuar të përfundojë me mbylljen e periudhës së pyllëzimeve të vitit 2023. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kushtet teknike dhe atmosferike që kërkon procesi i pyllëzimeve (mbjellja e fidanëve) nuk mundëson parashikime të ditëve (fikse) për kryerjen e punimeve.*
- *Aktiviteti/veprimtaria e objekt denoncimi, nuk është organizuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Në këtë veprimtari institucioni ynë ka qenë thjesht pjesëmarrës në aktivitet dhe për rrjedhojë nuk mund të raportonte për zhvillimin e këtij aktiviteti. Konkretisht, ky aktivitet ishte një ndër aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit të lartpërmendur dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, u kërkuua me rastin e përfundimit të punimeve të pyllëzimeve në Ekonominë Pyjore “Përparimaj-Dardhë”, në vendin e quajtur Dëmbravë. Sa më sipër dhe në përmbushje të detyrime që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, garanton se do të raportojë në respektim të afateve ligjore çdo aktivitet/veprimtari që do të organizohet nga ana e saj, deri në përfundim të peridhës zgjedhore.”*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancën dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve i cili lidhur me aktivitetin objekt denoncimi bëri me dije se: *“...aktiviteti nuk është zhvilluar nga Agjencia. Kemi kthyer përgjigje me shkrim brenda afateve ligjore në e-mail dhe kemi depozituar parashtrimet dhe faktet shkresore, që provojnë që nuk ka përgjegjësi për mosraportimin. Ky aktivitet është kryer nga bashkia Devoll më konkretisht nga Agjencia e Pyjeve dhe Mjedisit e bashkisë Devoll në kuadër të një projekti të miratuar më parë të parashikuar nga buxheti i bërë në vitin 2022. Një projekt i ndjekur me të gjitha hapat ligjor, është konfirmuar nga prefekti, ka marrë miratimet përkatëse sipas instancave shtetërore dhe është ndjekur sipas fazave. Ne kemi qenë në rolin e monitoruesit.*

Kemi detyrim ligjor për të asistuar për të monitoruar kontrolluar të gjitha projektet dhe gjitha veprimtaritë zbatuese që ndikojnë apo përmirsojnë fondin pyjor kombëtar. Ne nuk kishim detyrim ligjor për t'i raportuar KQZ për këtë aktivitet ndaj kërkojmë pushimin e hetimit administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.”

Në vijim të hetimit administrativ është kërkuar informacion, nëpërmjet postës elektronike, mbi deklaratimet e mësipërme edhe **bashkisë Devoll** e cila ka bërë me dije se:

- *Projekti i pyllëzimeve është hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit të bashkisë Devoll. Ky projekt ka nisur të zbatohet që prej vitit 2022 dhe është parashikuar të përfundojë me mbylljen e periudhës së pyllëzimeve të vitit 2023. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kushtet teknike dhe atmosferike që kërkon procesi i pyllëzimeve (mbjellja e fidanëve) nuk mundëson parashikim të ditëve (fikse) për kryerjen e punimeve.*
- *Aktiviteti/veprimtaria objekt denoncimi, është organizuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit të bashkisë Devoll. Në këtë veprimtari institucioni ynë nuk ka zhvilluar aktivitet me publik të gjere apo me qëllim për ta përdorur për fushate. Konkretisht, ky aktivitet ishte një ndër aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit të lartpërmendur dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, u kërkuar me rastin e përfundimit të punimeve të pyllëzimeve në Ekonominë Pyjore “Përparimaj-Dardhë”, në vendin e quajtur Dëmbravë...*
- *Sipas vendimit Nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, neni 3, pika 1.1 parashikimi mbi “veprimtari të ndaluar për tu promovuar, ky projekt ka nisur të zbatohet që prej vitit 2022 dhe është parashikuar të përfundojë me mbylljen e periudhës së pyllëzimeve të vitit 2023, pra ky organizim nuk bën pjesë në veprimtari të ndaluar për tu promovuar...*
- *E theksojmë edhe një herë duke kërkuar mirëkuptimin tuaj se kushtet teknike dhe atmosferike që kërkon procesi i pyllëzimeve (mbjellja e fidanëve) nuk mundëson parashikim të ditëve (fikse) për kryerjen e punimeve, për këtë arsye ka qenë e pamundur nga ana jonë të njoftohej 5 ditë përpara për këtë organizim. Sa më sipër dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, bashkia Devoll, garanton se do të raportojë në respektim të afateve ligjore çdo aktivitet/veprimtari që do të organizohet nga ana e saj, deri në përfundim të periudhës zgjedhore.*

Përsa më sipër, nga verifikimi provave dhe fakteve si dhe të dhënave të deklaruara nga palët në këtë proces administrativ, rezultoi se Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka qenë organizatore e kësaj veprimtarie dhe për pasojë, nuk ka patur detyrimin për të raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në respektim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se, aktiviteti i kryer nga ana e bashkisë Devoll nuk është veprimtari e cila ka pasur detyrimin për raportim jo vetëm për shkak të tematikës së saj, por edhe pasi është e mbyllur për pjesëmarrësit.

Aktiviteti nuk ka pasur pjesëmarrje të mediave dhe ka qenë aktivitet ndërinstitucional. Në përfundim të hetimit, u vlerësua se referuar nenit 92 të Kodit Zgjedhor, aktivitetit i kryer nga bashkia Devoll, nuk përfshihet në kategorinë e veprimtarive që kanë mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5- Denoncimi regjistruar me nr. 214 ID ndaj Bashkisë Fier, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 214 ID, "Kallm, Fier Robert Etsi është një prej atyre fermerëve fierakë, që falë punës, përkushtimit, sakrificave ka arritur të ketë sot një biznes të suksesshëm agrobujqësor një pikë grumbullimi e farërave dhe inpueteve bujqësore, duke i ardhur në ndihmë gjithë fermerëve të zonës së Fierit dhe jo vetëm.**

Prova link:

<https://www.facebook.com/armandosubashi.al/videos/955845602092187>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 28.3.2023, bashkisë Fier i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 30.3.2023 jemi informuar se: "Ky aktivitet ka qenë i planifikuar për tu zhvilluar që në datën 20, por për shkak se nuk ishte bërë përlllogartitja e ditëve në mënyrë korrekte nga ana jonë e spostuam për ta zhvilluar në datën 24. 02. 2023. Raportimi është bërë që në datën 18.02.2023 në ndërfaqen e KQZ-së me objekt: Vizitë në fabrikën e miellit Mokra, në mobilierine XG, në thertoren Semanjaku, në një pikë grumbullimin drithërash.

Sikurse vihet re një nga sipërmarrjet private që janë planifikuar për tu vizituar ka qenë: Një pikë grumbullimi i drithërave dhe bëhet fjalë për pikën e grumbullimit të Robert Etsi në Kallm i Vogël. Sa më sipër ju konfirmojmë se ky aktivitet është zhvilluar në ditën dhe orën e raportuar në ndërfaqen e KQZ-së (24.02.2023).

Nëse i referohemi raportimit të bërë shihet qartë se nuk kemi të bëjmë me një aktivitet publik, por me një vizitë të qytetarit të parë të bashkisë në disa sipërmarrje private ku qëllimi është njohja nga afër e punës, produktit, arritjeve dhe sfidave, kjo me synim krijimin e një panorame

më të plotë të situatës së sipërmarrjeve private kryesisht në fushën e agropërpunimit. Sikurse është raportuar, kjo ka qenë thjesht një vizitë ku nuk ka patur asnjë media dhe as ka qenë një aktivitet i hapur për publikun. Duke patur parasysh qëllimin e këtyre vizitave (e lartëcituar), ka qenë thjesht një bashkëbisedim miqësor me përfaqësuesit e këtyre sipërmarrjeve në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Këto vizita nuk kanë patur si qëllim as të informojnë këta persona apo grup personash me ndonjë mundësi mbështetjeje, as me ofrimin e ndonjë lehtësie nga ana e qeverisjes vendore apo qendrore, apo të informojë/promovojë ndonjë akt politik.

Përsa i përket publikimit të këtyre vizitave, ato janë publikuar në rrjetin social facebook të Armando Subashi. Pasqyrimi i aktiviteteve në këtë rrjet social bëhet sipas mundësisë dhe hapësirës. Asnjëherë nuk kemi thënë që do i pasqyrojmë në kohë reale. Jo vetëm këtë aktivitet, por përgjithësisht nuk e bëjmë këtë gjë. Në praktikën e punës ne i pasqyrojmë aktivitetet, takimet kur të shikojmë mundësinë sipas një grafiku të përcaktuar në bazë të ndjekshmërisë dhe shikueshmërisë në rrjetet sociale.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Fier.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se pjesëmarrja e z. Balla në këtë takim lidhet me detyrat funksionale të deputetit. Po ashtu nga këqyrja e materialit video rezultoi se në këtë takim nuk evidentohen thirrje elektorale apo thirrje për të votuar kandidatin në zgjedhje. Aktiviteti i kryer nga ana e bashkisë Fier nuk është veprimtari e cila ka pasur detyrimin për raportim jo vetëm për shkak të tematikës së saj, por edhe pasi është e mbyllur për pjesëmarrësit.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi u morën në shqyrtim të dhënat e çështjes dhe tematika e veprimtarisë publike, referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor, vlerësoj se aktivitetit i kryer nuk përfshihet në kategorinë e veprimtarive që mbartin detyrimin për raportim në ndërfaqen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6- Denoncimi regjistruar me nr. 218 ID ndaj Bashkisë Lezhë, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 218 ID, "Në takim me komunitetin (autokton) Lezhjan ku ndamë ngjarje, zhvillime dhe vizione të përbashkëta. Ky komunitet shquhet për tolerancë, punë, pozitivitet mikpritje, gjë të cilën ma kanë përcjellur edhe si qytetar edhe si kryebashkiak, dhe për këtë ndihem pafundësisht mirënjohës. Lezha ka pësuar transformim total në 4 vitet e fundit, dhe**

*jam optimist që në 4 vitet e ardhshme së bashku do e shndërrojmë në kryevepër!
#tebashkuarjotendare #ShqipëriaEArdhmjaJoneAL #SkaKohePerPushim*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=1895807614088079&set=pcb.18958078640880543>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 28.3.2023, bashkisë Lezhë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por institucioni nuk i është përgjigjur kërkesës.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 27.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Lezhë.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të pamjeve dhe provave të administruara u vlerësua se natyra e aktivitetit të kryer është i karakterit politik dhe nuk është veprimtari publike e institucionit të bashkisë.

Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të aktiviteteve me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete të cilat organizohen nga kjo forcë politike dhe të shprehë mendimet e veta. Këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve. Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:

Data: 9 Maj 2023

Nr: 469

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

- a) Z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
 - b) Z. Astrit Seferkollu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për:
- a) Z. Artur Kala, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Agjencinë Kombëtare e Pyjeve;
 - b) Z. Florenc Cerhozi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Krujë;
 - c) Z. Reinis Çela, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë;
 - d) Z. Martin Dodi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Fier.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI